

VENDIM
Nr. 372, datë 1.6.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 200, DATË 25.3.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE
ARSIMORE NË BASHKITË MIRDITË DHE KAMZË DHE CAKTIMIN E TYRE SI
NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, në masën 346 791 450 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Azem Hajdari”, Zall-Mëner, Bashkia Kamzë, fondi në masën 55 923 450 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022;

b) për rikonstruksionin e gjimnazit “Isa Boletini”, fondi në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe 184 248 000 (njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë;

c) për rikonstruksionin e kopshtit Zall-Mëner, fondi në masën 56 620 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”.

2. Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Mirditë, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, në masën 49 636 970 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

II. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj